



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2019:294123

Datë: 02.04.2024

Numri i dokumentit: 05532490

K.DH.SH.II.nr.263/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Ramush Bardiqi kryetar, Dren Rogova dhe Krenar Berisha, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit New Line ShPK, me seli në Prishtinë, të cilët sipas autorizimit e përfaqëson Hidajete Mazhiqi avokate nga Mitrovica, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.107/22 të datës 12.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa e paditësit New Line ShPK, me seli në Prishtinë.

II. Priset Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës -Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.107/22, i datës 21.12.2023, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e ankimuar me ankesë, të Gjykatës Komerciale të Kosovës –Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, është hedhë poshtë padia e paditësit New Line ShPK, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit Nr.PSH. 780/19 e datës 02.12.2019 si e paplotësuar.

Kundër këtij aktvendimi, paditësi ka ushtruar ankesë, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që të aprovohet ankesa dhe lënda KA.nr.107/22 e datës 12.12.2023 Priset dhe çështja kthehet në rigjykim. Ankesës se paraqitur ia ka bashkangjitur vendimin kontestues PSH nr. 780/19.

Kolegji i kësaj Gjykate, shqyrtoi shkresat e lëndës, padinë e paditëses dhe pretendimet në ankesë dhe pas vlerësimit edhe të shkresave të tjera të lëndës, si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, dhe

neni 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së), gjen se:

### **Ankesa është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë në procedurë të shqyrtimit paraprak të padisë më datë 07.10.2022, merr aktvendimin, KA.nr.107/22, e fton paditësin që në afat prej 8 ditësh, të bëjë plotësimin e saj, ashtu që t'ia dorëzoj Gjykatës dy kopje të aktit administrativ të cilin e kundërshton dhe kopjen e të gjitha shkresave të lëndës që kanë të bëjnë me çështjen konkrete sipas padisë së saj të cilin aktvendim paditësi sipas fletë-kthesës së nënshkruar e ka pranuar 07.10.2022. Me parashtresën e dt.16.01.2023 përfaqësuesja e paditësit ka deklaruar se sipas kërkesë se gjykatës me aktvendimin ia bashkëngjisë dhe gjitha shkresat ne kopje te mjaftueshme. Ne seancën e dt. 14.11.2023, pas deklarimit te përfaqësuese se paditësit lidhur me padinë gjykata ka kërkuar nga paditësja se nëse me parashtresën e dt. 16.11.2023 e ka dorëzuar vendimin kontestues, paditësja ka deklaruar se i ka dorëzuar parashtresat qe i ka pas, ndërsa lidhur me vendimin ka deklaruar se sot nuk e ka por do te konsultohet me paditësin. Gjykata pas konstatimeve se paditësja e ka pranuar aktvendimin me dt. 13.10. 2022 lidhur me plotësimin e padisë përkatësisht qe te dorëzohet aktvendimi kontestues ka marr aktvendim me te cilin e ka hedhe poshtë padinë paditës si te paplotësuar, konform nenit 33 parag. 2 i LKA-se. Tutje ne vendimin e atakuar është theksuar se pasi që paditësi nuk ka vepruar në kuptim të kësaj urdhërese të gjykatës dhe brenda afatit ligjor, nuk i ka mënjanuar të metat e padisë, kurse ato janë të atilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata vendosi në kuptim të dispozitës së nenit 30 lidhur me nenin 33 të LKA-së.

Kolegji i Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së dytë duke ekzaminuar aktvendimin e Gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të ankesës, gjen se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë në këtë çështje juridike kontestuese nuk është i pranueshëm, pasi që aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të Procedurës Kontestimore nga neni 182 prag. 2 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, sepse në kundërshtim me dispozitat e nenit 33 të LKA-së, gjykata ka nxjerr aktvendim për hedhjen poshtë të padisë.

Mbi këtë gjendje të fakteve Kolegji i kësaj gjykate, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë çështje juridike administrative nuk ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe ligjore me hedhjen poshtë të padisë, kur në rastin konkret ka aplikuar dispozitën e nenit 33 paragrafi 2. Gjykata nuk mund te pranoje qëndrimin juridik te gjykatës se shkalles parë, për arsye se, nuk ishte kontestuese se ne baze te flet kthesës ishte pranuar vendimi për plotësimin e padisë, gjithashtu nuk ishte kontestuese as dorëzimi i parashtresës nga përfaqësuesja paditësit e dt. 16.11.2023, ne përmbajtje te se cilën ishte deklaruar se sipas kërkesë se gjykatës me aktvendimin ia bashkëngjisë dhe gjitha shkresat ne kopje te mjaftueshme. Dispozitat ligjore te lartecekuar gjykata e shkallës së parë do të mund ta zbatonte gjate në shqyrtimin paraprak të padisë, mirëpo në rastin konkret, kur gjykata e shkallës së parë me datën 14.11.2023 ka hap seancë publike, në të cilën përfaqësuesja e autorizuar e paditësit ka deklaruar se “*vendimin sot nuk e kame por do të konsultohet me paditësin*”. Nisur nga ky fakt kolegji i kësaj gjykate konsideron se gjykata e shkallës së parë është dashur t'i jap mundësi paditësit që deri në një afat të caktuar nga vet gjykata të bëjë dorëzimin e aktit administrativ kontestues, kjo bazuar në dispozitën ligjore të nenit 33 parag. 2 te LKA. Kolegji konsideron se ne rrethanat e rastit konkret, dhe konstatimeve te lartecekura gjykata e shkalles se pare nuk i ka dhënë mundësi palës qe te prezantoj provën përkatësisht vendimin

kontestuese, me ç' rast ka cenuar te drejta procedurale te paditësit, për prezantimin e provave para gjykatës se shkallës e parë. Pikëpamjet juridike të gjykatës se shkallës se parë, Kolegji i kësaj gjykate nuk mund t'i përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm tani për tani, për arsye se, aktvendimi i atakuar është përfshirë ne të meta thelbësore të dispozitave të LKA-së, për të cilën arsye u deshtë që të priset aktvendimi i ankimuar dhe lënda kthehet ne rishqyrtim gjykatëse se shkallës së parë, për procedim me tutje sipas padisë se paditësit.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 209 pika d) të LPK-së të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II.nr.263/24 datë 28.03.2024

Kryetar i Kolegjit, gjyqtari  
Ramush Bardiqi